

# *buletini* info

Buletin informativ mujor  
Janar, 2023



## KRYEMINISTRI I KOSOVËS ALBIN KURTI PRITI NË TAKIM STUDENTËT PËRFITUES TË BURSËS SË NDARË NGA QEVERIA



Takime me diasporën  
tonë në Zvicër



Kur Ibri vërshon!



Fëmijët hiperaktiv



## TAKIME ME DIASPORËN TONË NË ZVICËR

Kryetari i IRDK-së, i shoqëruar nga zëvendëskryetari i IRDK-së Fridon Lala, Sekretari Organizativ Mergim Neziraj dhe anëtari i KQZ-së Fazli Stollaj, me datën 27 dhe 28 janar të këtij viti, kanë vizituar pjesëtarët e diasporës në kantonin Obwalden dhe Tichinos të Zvicrës. Qëllimi i këtyre takimeve ishte që të falënderohet diaspora jonë në Zvicër për kontributin shumë vjeçar për zhvillimin e lëvizjeve politike të Egjiptianëve të Kosovës, të informohen lidhur me projektet dhe punët që po zhvillohen nga Qeveria e Kosovës. Në veçanti lidhur me projektet që prekin komunitetin Egjiptian e që ishin edhe premtime elektorale të IRDK-së në zgjedhjet e fundit parlamentare.

Në takimet e datës 27.01.2023, të organizuar nga z.Selim Golla me bashkëpunëtor, në Sarnes, dhe me datën 28.01.2023 në Bellinzona nga Kryetari i degës së Zvicrës z.Flamur Ajetaj me bashkëpunëtor, Ministri Elbert Krasniqi i ka falënderuar të gjithë aktivistët dhe mbështetësitë e IRDK-së në Zvicër, për besimin që i dhanë IRDK-së në zgjedhjet Parlamentare të vitit 2021. Ministri Elbert Krasniqi me bashkëpunëtorët e tij nënvizuan faktin e implementimit të projekteve infrastrukturore me bazë në komunitet, vlera e të vilave në asnjë Qeveri nuk ka qenë më e lartë.

Duke e falënderuar diasporën tonë të cilët për një kohë të gjatë kishin mbledhë mjete vetanake për të dhënë bursa për studentët tanë në Kosovë, të pranishmit në takimi u informuan për faktin e ndarjes së bursave për të gjithë studentët e komunitetit tonë të cilët po përfitojnë nga Qeveria e Kosovës me qëllim që të lehtësohen studimet dhe numri i studenteve të jetë më i madh. Gjithashtu të pranishmit janë informuar edhe zbatimin e projekteve humanitare nga kuzhinat popullore për familjet skamnore, për projektet e realizuara në Gjakovë lidhur me pastrimin e deponisë së mbeturinave në lagjen Ali Ibra dhe për projektin që planifikohet që të zbatohet gjatë këtij viti në Fushë Kosovë për ujin e pijes i cili e arrin vlerën e rreth 3 milion euro. Ministri dhe deputeti i IRDK-së i kanë njoftuar të pranishmit edhe për projektin e ndërtimit dhe renovimit të shtëpive gjatë vitit 2023, për mundësinë e punësimit në Policinë e Kosovës, FSK dhe institucionet tjera të Kosovës.

Të pranishmit në këto dy takime shumë vëllazërore, kanë bërë biseda dhe pyetje për mysafirët nga Kosova dhe me sinjeritet janë pranuar këshillat dhe kritikrat me dëshirën e madhe për të punuar sa më mirë dhe për të pasur rezultate më të mëdha në fund të mandatit.







## **KRYEMINISTRI I KOSOVËS ALBIN KURTI PRITI NË TAKIM STUDENTËT PËRFITUES TË BURSËS SË NDARË NGA QEVERIA**

Kryeministri i Qeveris së Republikës së Kosovës, i shoqëruar nga Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Elbert Krasniqi dhe Ministrja e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arberie Nagavci me datën 25.01.2023 janë takuar me studentët nga komunitetet Egjiptian, Ashkali dhe Rom të cilët kanë përfituar bursa si rezultat i marrëveshjes në mes të MAPL-së dhe MASHTI.

Studentët, përfitues të bursës janë duke studiuar në Fakultetin e Mjekësisë, Inxhinierisë Mekanike, Edukimit, Filozofisë etj. Pra janë profile të ndryshme mirëpo me një qëllim të njëjtë dhe të përbashkët që të krijohen gjeneratat e reja të profesionistëve dhe intelektualëve nga radhët e komuniteteve.

Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të mbështetjes së edukimit të lartë tek studentët nga radhët e komuniteteve, mbështet të gjithë studentët e Universiteteve Publike në Kosovë me bursë të plot studimi. Nga viti i parë i studimeve u mbështetën 26 studentë, në ditët në vijim do të vazhdohet me përkrahje edhe për studentë të viteve të tjera të studimit.



*Kryeministri i Kosovës Albin Kurti priti në takim studentët përfitues të bursës së ndarë nga Qeveria*



*Kryeministri i Kosovës Albin Kurti priti në takim studentët përfitues të bursës së ndarë nga Qeveria*

## MINISTRIT ELBERT KRASNIQI TAKON KRYATARET E KOMUNAVE TË KOSOVËS



Me datën 10.01.2023, Ministri i MAPL-së, Elbert Krasniqi, ka zhvilluar një takim koordinues me Kryeministrin z. Albin Kurti, Ministrin z. Hekuran Murati, Ministren znj. Artane Rizvanolli dhe Kryetarët e Komunave. Në këtë takim është diskutur për bashkëpunimin në mes nivelit qendror dhe atij lokal.

Në fjalën e tij, ministri Elbert Krasniqi ka vendosur në theks të veçantë reformat ligjore në kuadër të agjendës legislative të MAPL-së, financimin e projekteve komunale me qëllim të zhvillimit ekonomik lokal dhe ofrimin e shërbimeve sa më kualitative për qytetarët duke u bazuar në digjitalizimi dhe efikasitet. për të krijuar hapësira të gjelberta në vendin ku kanë pushuar mbeturinat për shumë vite.





## MINISTRI ELBERT KRASNIQI TAKON MINISTRIN E MBROJTËS ARMNED MEHAJ

Me datën 11.01.2023, Ministri i MAPL-së, Elbert Krasniqi, ka zhvilluar takim me Ministrin e Mbrojtjes, Armend Meha. Në këtë takim është biseduar për mundësinë shumë të mirë për të riijnët dhe të rejat nga komunitetet Egjiptian, Ashkali dhe Rom për tu bërë pjesë e FSK-së. Ministria e Mbrojtjes ka shpallur të hapur konkursin për rekrutimin e 612 ushtarëve aktivë dhe 388 pjesëtarëve të komponentës rezervë të FSK-së. Komunitetet tona janë pjesë e rëndësishme e secilës fazë të shtet ndërtimi, pra edhe kjo thirrje është mundësi e mirë për të dhënë kontributin tonë duke u bërë pjesë e FSK-së dhe duke shërbyer me detyrë dhe dinjitet.



## KRYEMINISTRI DHE MINISTRAT E QEVERISË SË KOSOVËS VIZITOJNË ISTOGUN

Me datën 20.01.2023, Ministri Elbert Krasniqi, bashkë me Kryeministrin Albin Kurti dhe ministrin e Mbrojtjes, Armend Mehaj vizituan pjesëtarët e FSK-së të cilët me kamion ushtarak dhe barkë lundruese, e bënë të pamundurën që t'iu dalin në ndihmë banorëve të fshatit Drejë, në Istog.

Tek "Ura në Drejë", mbi lumin Kujavç, Kryeministri dhe Ministrat janë pritur nga kryetari i komunës Ilir Ferati i cili i njoftoi me gjendjen e vështirë në këtë komunë për shkak të vërshimeve. Më pas, ata kanë vazhduar për në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare ku vizituan dy familje të evakuara nga Zallqi: Arton dhe Luljeta Jahajn me katër fëmijë të vegjël, dhe, Avdi e Floreta Jahajn me dy fëmijë të vegjël. Përveç dëmeve të konsiderueshme materiale nuk ka qytetarë të vdekur e as të lënduar.



## KUR IBRI VËRSHON!



**Jeton Rrahmani**

Ibri, Lushta, Sitnica dhe Trepça janë 4 lumenjtë e Mitrovicës. Të gjithë këta janë jetik për qytetin e në veçanti Ibri, i cili komunën e Mitrovicës e përshkon rreth 15 kilometra. Për veç rëndësisë së tij për pijen dhe pamjës piktoreske njihet si simbol i Mitrovicës, madje i janë dedikuar edhe vargje këngësh si " Ibër lum i gjatë, gjaku i lirisë..." Njihet ndryshe si lum i dhimbjës pasi që mbi të ndodhet ura që e ndan qytetin e minatorëve. Krahas me Sitnicën dhe Lushtën që vërshojnë thuajse çdo vit, Ibri njihet si lum që nuk vërshon shpesh. Në këso situatë emergjente e shumica e qytetit në ujë nuk mbahet në mend që nga viti 1979. Në vitin 2023, Ibri vërshoi duke depërtuar në rrugë e vendbanime duke pasuar me dëme të konsiderueshme materiale. Nuk e kurseu as lagjen "Adem Voca" që është lagjia më e madhe e komuniteteve Rom Ashkali edhe Egjiptian në Mitrovicë e që shtrihet buzë lumit Ibër. Kaosi ishte prezent kudo pasi që banorët e kësaj lagje nuk ishin mësuar më parë me situata të tilla. Pas 2 ditësh Sitnica i'u bashkua tërbimit të Ibrit duke vërshuar "2 Korrikun" lagje tjetër e banuar me këto

komunitete. Reagimi i institucioneve lokale e qendrore ishte i menjëhershëm duke evakuar të prekurit e duke ofruar ushqim, strehim dhe gjërat e nevojshme elementare për çfarë meritojnë falenderim të veçantë. Situatë e rëndë për tu parë por fatkeqësisht në të kaluarën dikush i priste me padurim fatkeqësitë natyrore që të futej më qizme në ujë për një foto e të rriste cmimin e këtyre të fundit për të trashur pak xhepin e të merrte primatin me video në rrjete sociale. Një mend përfaqësim se jo mahi, aktivist që vjedhnin edhe në qizme. Pse saktësisht tash e dy vite të gjitha partitë politike me aktivistët e tyrë kishin zbarkuar në brigjet e Sitnices ? Ku janë ata kur Ibri e Sitnica vërshojnë sot e banorët nuk kishin ku ta bënë gjumin ? Pse nuk erdhën për vizitë e për ndihmë në Mitrovicë si në të kaluarën ? Përgjigjia e gjithë këtyre pyetjeve është e thjeshtë: nuk janë afër zgjedhjet! Fatkeqësi kur edhe fatkeqësinë e shohin si mundësi për përfitim votash. U djeg edhe kjo kartë e fundit prandaj sot kur Ibri vërshon kemi komplet situatë tjetër ku të gjithë akterët e këtyre komuniteteve, ishim bashkë për një qëllim të vetëm. Reagimi, ndihma, planifikimi e kordinimi me njëri tjetrin ishin rruga e vetme për tejkalimin e situatës emergjente dhe kthim në normalitet dhe kështu ngjau, për herë të parë u lanë anash përçarjet politike, dallimet etnike, pabarazitë e interesat personale. Sepse përtej gjendjës së jashtëzakonshme me vërshimet, jemi në përmbytje e kaos të përditshëm duke mos arritur synimet e përbashkëta, është pikërisht mos bashkëpunimi i duhur ai që na ka lënë mbrapa në arsim, mirëqenje sociale, zhvillim ekonomik e përfaqësim lokal. Kur Ibri vërshon na gjen me një gjeneratë të re të aktivistëve që ndihmën e shohin si diçka humane, humanen si obligative e obligativen si ideal, pra aktivistët me ideale janë hapi i parë drejt përmisimit të imazhit të komuniteteve jo shumicë, ngritjen e vetëdijësimit dhe progresit shoqërorë Kur Ibri vërshon na mëson se vetëm të bashkuar e tejkalojmë çdo sfidë, na mëson unitetin, na mëson të përbashkëtën para individuale. Si duket vërshimet e Ibrit na mësojnë se si duhet të "vërshojmë" ne të gjithë së bashku për për shpëtimin tonë real.



## FËMIJËT HIPERAKTIV

### Prof. Musli Ferizaj

Dëshirë e çdo prindi është që fëmija i tij të këtë sjellje shembullore dhe sukses të shkëlqyer në mësim. Kjo është e kuptueshme nga se niveli i edukatës dhe arsimit varet ardhmëria e tij dhe e shoqërisë në përgjithësi.

Prandaj me të drejtë thuhet se fëmijët duhet të bëhen më të mirë se prindërit dhe mësimdhënësit e tyre. Por kjo nuk arrihet gjithmonë sepse këtu siç dihet ndikojnë shumë faktorë:

Familja, në entet prarashkollore, sistemi shkollorë, zhvillimi psikofizik i fëmijëve, motivimi dhe shkalla e integritimit emocional të fëmijëve.

Në integrimin emocional të fëmijëve rol të rëndësishëm luan pjekuria emocionale e prindërve. Fëmijët kanë nevojë për dashuri prindërore, por jo të tepruar.

Fëmijët nuk duhet përkëdhelur së tepërmi sepse fëmijët e tillë nuk bëhen të pavarur.

Ata rriten pa autoritet, nuk përvetësohen më kohë normale shoqërore. Bëhen të pasigurt, të luhatshëm, vetiak, jotolerant dhe pa shprehi pune. Mendojnë se mund t'i kenë krejt çka dëshirojnë. Fëmijëve të tillë duhet parashtruar detyra të cilat ata mund t'i kryejnë në mënyrë që të bëhen të pavarur dhe të fitojnë mësim më vetvete. Nuk duhet kritikuar shumë sepse ata bëhen nervozë. Pra duhet pas durim në edukimin e tyre.

Të disa fëmijë ekziston një pengesë e quajtur "Sindrom hipërkenetik".

Në raste të tilla duhet konsultuar me pediatrin.

Fëmijët e tillë vërehen qysh nga lindja sepse qajnë më zë të lartë. Ata janë shumë aktiv, lëvizin shumë, kanë vëmendje të papërqendruar, janë agresiv. Detyrat iu marrin shumë kohë dhe bejnë gabime.

Nuk kanë sukses, janë të dobët në mësim.

Këta fëmijë mund të shërohen me psikoterapi dhe medikamente. Duhet pasur kujdes në dietë.

Mos të teprohet më shqime të cilat përmbajnë shumë fosfate si :

Çokollata, jogurti, coca cola, lëngje industriale.

Prindërit duhet të jenë të qetë. Nuk duhet frikësuar fëmijët për mungesë dashurie.

Hulumtimet kanë treguar se më kohë pengesa hipërkenetike zvoglohet te këta fëmijë.

Kjo duhet të jetë ngushëllim për prindërit.

Megjithatë të këta fëmijë mbesin disa shqetsime në rini si, aktiviteti tepertë dhe qetësimi i ngadaltë.



## HISTORIKU I KRIJIMIT TË BASHKIMIT EVROPIAN

Bashkimi Evropian është një bashkësi e disa shteteve Evropiane e themeluar me qëllim të lirisë së qarkullimit të mallrave. Në fillim të themelimit përbëhej nga një numër i vogël shtetesh. Me rënien e Bashkimit Sovjetik, u bë paraqitja e kërkesave për anëtarësim nga shtete ish-komuniste. Edhe pse si organizatë gjithë-Evropiane është Këshilli i Sigurimit të Evropës, nga shumë vende të botës edhe BE njihet si organizatë gjithë Evropiane.

Guri i themelimit për krijimin e Bashkimit Evropian u vendos nga Ministri i Jashtëm Francez, Robert Schuman, në deklaratën e tij të 9 majit të vitit 1950, në të cilën ai parashtrijoi idenë e përpunuar më parë me Jean Monnet për bashkimin e industrive evropiane të qymyrit dhe çelikut. Sipas tij, kjo do të përbente një nismë historike për ndërtimin e një "Evrope të organizuar dhe vitale", pa të cilën paqja në botë do të ishte e pamundur. Plani Schuman u bë realitet me nënshkrimin në Paris të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut më 18 prill të vitit 1951. Në nënshkrimin e traktatit merrnin pjesë: Gjermania, Franca, Belgjika, Italia, Holanda dhe Luksemburgu. Një tjetër zhvillim i rëndësishëm erdhi disa vjet më vonë me Traktatet e Romës, të 25 marsit të vitit 1957, të cilat krijuan Komunitetin Ekonomik Evropian dhe Komunitetin Evropian të Energjisë Atomike (EUROATOM). Këto komunitete filluan nga puna me hyrjen në fuqi të traktateve më 1 janar të vitit 1958. Krijimi i Bashkimit Evropian me Traktatin e Mاستrihtit shënoi një hap te mëtejshëm në rrugën e bashkimit politik të Evropës. Megjithëse ky traktat u nënshkrua më 7 shkurt të vitit 1992, një numër pengesash gjatë procesit të ratifikimit (miratimi nga qytetarët e Danimarkës vetëm pas një referendumi të dytë; procesi gjyqësor në Gjermani për deklarimin antikushtetues të miratimit) bënë që Traktati të mos hynte në fuqi deri më 1 nëntor të vitit 1993. Traktati i Mاستrihtit i referohet vetvetes si "një fazë e re në procesin e krijimit të bashkimit akoma më të ngushtë ndërmjet popujve të Evropës". Krahas një numri ndryshimesh për Traktatet e Komunitetit Evropian dhe Euroatomit, ai përmban edhe instrumentin për krijimin e Bashkimit Evropian - procesi për krijimin e së cilit ende konsiderohej si i papërfunduar. Traktati përbën hapin e parë në rrugën drejt krijimit të një sistemi kushtetues Evropian, në të cilin do të përfshihen edhe vetë komunitetet.



Bashkimi Evropian mori një zhvillim të mëtejshëm me Traktatin e Amsterdamt i cili u nënshkrua me 1 tetor të vitit 1997 dhe hyri në fuqi më 1 maj të vitit 1999 pas ratifikimit nga të gjitha shtetet anëtare. Traktati i Amsterdamt ka modifikuar përmbajtjen e Traktatit të Masihtit në pesë fusha kryesore:

- liria, siguria dhe drejtësia,
- qytetaria e Bashkimit,
- politika e jashtme,
- institucionet e BE-së

Gjate samitit të Nicës më 7-11 dhjetor 2000, kryetarët e shteteve dhe të qeverive si dhe ministrat e jashtëm të shteteve anëtare, pas një maratone të gjatë bisedimesh, ranë dakord për miratimin e një kushtetute për Bashkimin Evropian. Traktati i Nicës përmban dispozita mbi ndarjen e pushteteve dhe procedurat vendimmarrëse të BE-së. Traktati u miratua në mënyrë përfundimtare nga qeveritë e shteteve anëtare më 26 shkurt të vitit 2001, datë kur u nënshkrua nga ministrat e jashtëm. Pas kësaj, hyri në fuqi më 1 shkurt 2003, pas ratifikimit nga parlamentet e të gjitha shteteve anëtare.



## PËRKATËSIA ETNIKE DHE IDENTITETI ETNIK

**P**ërkatësia etnike mund të imagjinohet si një formë e organizimit shoqëror të dallimeve kulturore, e përbërë nga ato karakteristika që vetë anëtarët e bashkësisë etnike i konsiderojnë të rëndësishme për veten e tyre dhe që qëndrojnë në themel të vetëdijes së tyre. Këto karakteristika përfshijnë gjithashtu zotërimin e një ose më shumë emrave të zakonshëm, elementet e përbashkëta kultura, ideja e një origjine të përbashkët dhe, si rrjedhojë, prania e një kujtese të përbashkët historike. Në të njëjtën kohë, ka shoqata të vetes me një territor të veçantë gjeografik dhe një ndjenjë solidariteti grupor.

Përkufizimi i përkatësisë etnike ndërtohet edhe mbi bazën e vetëidentifikimit kulturor të një bashkësie etnike në raport me bashkësitë e tjera (etnike, sociale, politike) me të cilat ajo ka lidhje themelore. Si rregull, ekziston një ndryshim domethënës midis idesë brenda grupit dhe asaj të jashtme të përkatësisë etnike: kriteret objektive dhe subjektive janë të pranishme për të përcaktuar bashkësinë etnike. Dallimet në llojin antropologjik, origjinën gjeografike, specializimin ekonomik, fenë, gjuhën, madje edhe veçoritë e kulturës materiale (ushqimi, veshmbathja etj.) përdoren si kritere të tilla.

**I**dentiteti etnik është pjesë përbërëse e identitetit social të individit, vetëdija për përkatësinë e një bashkësie të caktuar etnike. Në strukturën e tij, zakonisht dallohen dy komponentë kryesorë:

- Njohës, njohuri, ide për karakteristikat e grupit të vet dhe vetëdije për veten si anëtar i tij bazuar në karakteristika të caktuara, dhe

- Afektiv, vlerësimi i cilësive të grupit të vet, qëndrimi ndaj anëtarësimit në të, rëndësia e këtij anëtarësimi.

Një nga të parët që zhvilloi vetëdijen e një fëmije për përkatësinë në një grup kombëtar u studiua nga shkencëtari zviceran J. Piaget. Në një studim të vitit 1951, ai identifikoi tre faza në zhvillimin e karakteristikave etnike:

- në moshën 6-7 vjeç fëmija merr njohuritë e para fragmentare për përkatësinë e tij etnike;

- në moshën 8-9 vjeç, fëmija tashmë identifikohet qartë me grupin e tij etnik, bazuar në kombësinë e prindërve, vendbanimin, gjuhën amtare;

- në adoleshencën e hershme (10-11 vjeç) identiteti etnik formohet plotësisht, si tipare të popujve të ndryshëm, fëmija vë në dukje veçantinë e historisë, specifikat e kulturës tradicionale të përditshme.

Ekzistojnë dimensionet e mëposhtme të identitetit etnik:

- identiteti mono-etnik me grupin e vet etnik, kur një person ka një imazh pozitiv për grupin e tij etnik me një qëndrim pozitiv ndaj grupeve të tjera etnike;

- ndryshimi i identitetit etnik të një personi që jeton në një mjedis multietnik, kur një grup etnik i huaj konsiderohet se ka një status më të lartë (ekonomik, social, etj.) se ai i tij. Kjo është tipike për shumë përfaqësues të pakicave kombëtare, për emigrantët e brezit të dytë;

- identiteti bietnik, kur një person që jeton në një mjedis multietnik zotëron të dyja kulturat dhe i njeh ato si njëlloj pozitive;

- identiteti marginal etnik, kur një person që jeton në një mjedis multietnik nuk zotëron mjaftueshëm asnjërën nga kulturat, gjë që çon në konflikte ndërpersonale (ndjenja e dështimit, pakuptimësia e ekzistencës, agresiviteti, etj.);

- identitet etnik i dobët (apo edhe zero), kur një person nuk e identifikon veten me asnjë grup etnik, por deklaron kozmopolit (unë jam aziatik, jam evropian, jam qytetar i botës) ose civil (unë jam demokrat, jam komunist) identitet.

Identiteti etnik në kuadër të qasjes institucionale

Qasja institucionale na lejon të gjurmojmë marrëdhënien midis identitetit dhe rregullave të sjelljes. Nga pikëpamja institucionale, identiteti është një algoritëm për zgjedhjen e rregullave për zgjedhjen e preferencave të caktuara. Identiteti etnik shihet si një rrugëdalje e ndërjegjshme shoqërore nga një situatë e pasigurisë institucionale, kur në të njëjtën kohë një agjent social duhet të ndjekë rregullat dhe të thyejë të paktën disa prej tyre. Tiparet institucionale të identitetit etnik janë se individët mund të lirisht dhe, si rregull, pa pasoja negative shkelin rregullat e pranuar në fushën e përdorimit të gjuhës, traditave kulturore, besimeve fetare etj., pa vënë në dyshim përkatësinë e tyre në një grup etnik. Forma të tjera të identifikimit social (për shembull, profesional) priren të kufizojnë aftësinë e individëve për të shkelur ose interpretuar rregullat e sjelljes. Stabiliteti i shumë identifikimeve etnike qëndron në dobësinë e tyre institucionale: është mjaft e lehtë të mbetesh pjesë e një grupi etnik që është tolerant ndaj devijimeve institucionale. Nëse një grup mjaft i madh njerëzish preferon të përdorë në sjelljen e përditshme devijime të ngjashme (përrjashtimet institucionale) nga rregullat e sjelljes të zakonshme për një etnogrup, mund të formohet një identitet nënetnik. Në këtë rast, devijimet fillestare në sjelljen shoqërore (për shembull, përdorimi i një modeli gjuhësor që është i ndryshëm nga gjuha e përdorur në "ish" grupin etnik) bëhen bazë për një identifikim të ri dhe individët do të vlerësohen në varësi të nëse janë në përputhje me normat e reja të sjelljes apo jo. Kështu, formimi i identitetit ndikohet nga shpërbërja institucionale e rregullave të sjelljes etnike.

# *buletini* info

Kontriboni me shkrimet e juaja autentike si:

Opinione

Kulturë

Histori

Shkencë

Dërgoni në email: [buletini.info@gmail.com](mailto:buletini.info@gmail.com)